



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/177
Datë: 08.12.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, pika 6 Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës për vitin 2023, Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 320,428.00€ (treqind e njëzet mijë e katërqind e njëzet e tetë euro) në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, për zbatimin e Programit "Masat preventive - intervenime emergjente" nëpër komuna të ndryshme.
2. Mjetet financiare nga 1. e këtij Vendimi rialokohen nga nën-programi "Mbrojtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore" me kod 81500, nga kategoria e Shpenzimeve Kapitale, përkatësisht në Projektin "Masat preventive - intervenime emergjente" me kod 12688, rialokohen në Projektin me kod 16151 - Taphanja, Gjakovë.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/177

Datë: 08.12.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 29 të Ligjit Nr.05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-034, nenit 6 (paragrafi 4, nën-paragrafi 4.2) të Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 13/2022 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes dhe Dhënies me Qira të Pasurisë së Luajtshme dhe të Paluajtshme të Sekuestruar dhe të Konfiskuar, në përputhje me Vendimin e Qeverisë Nr. 22/84, të datës 22 qershor 2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës, përkatësisht banesën 66.2 metra katrorë në Lagjen "Mati 1" 2B+P+8+NK Blloku A11 e konfiskuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. Nr. 1046/16, të datës 18 dhjetor 2014.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Oda e Ndërmjetësuesve merr përsipër dhe është përgjegjëse për të gjitha obligimet dhe detyrimet e banesës nga momenti i marrjes në shfrytëzim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/177
Datë: 08.12.2023

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për "Projektin e trajtimit të Ujërave të zeza në Ferizaj".
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë